

VENDIM
Nr.930, datë 2.9.2009

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
MARRËVESHJEN SHITESË TË KONCESIONIT PËR 25 HIDROCENTRALET
VENDORE, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË ITALIANE “ESSEGEI”, S.P.A, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.148, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “ESSEGEI”, S.p.A, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave”, sipas tekstit dhe aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN SHITESË TË KONCESIONIT
TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DHE SHOQËRISË ITALIANE “ESSEGEI” SPA, PËR 25 HIDROCENTRALET VENDORE,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.148, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në Tiranë, sot më 28 gusht 2009, para meje notere Fatime B.Meta, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë rruga e Durrësit, p.118, shk.1, ap.1, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.148, datë 22.3.2007, përfaqësuar nga titullari z.Genc Ruli, i biri i Pëllumbit, i datëlindjes 11.4.1958, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr.D0000374 dhe shoqëria “ESSEGEI” S.p.A., që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori i saj z.Giordano Gorini, i biri i Angelos, i datëlindjes 23.8.1965, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr.AA 2729065, me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë marrëveshje koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe kompanisë italiane “ESSEGEI” S.p.A, për rehabilitimin e 25 hidrocentraleve vendore, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467, datë 3.10.2002, të ndryshuar.

HYRJE

Duke marrë në konsideratë:

- kërkesën e OSHA-së për shkëputje nga koncesioni të HEC-eve, ku nuk është investuar për faj të koncesionarit;

- pengesat e hasura nga Koncesionari, jo për faj të tij, gjatë zbatimit të marrëveshjes së koncesionit, edhe pas ndryshimit të marrëveshjes bazë, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të cilat çuan në mosrealizim në kohë të investimeve të parashikuara;

- mirëkuptimin midis dy palëve (OSHA dhe Koncesionari) për shkëputje nga koncesioni të HEC-eve Piqeras, Lozhan dhe Voskpojë, jo vetëm për mungesë investimesh, por edhe për shkak ndërhyrjeje me koncesione të tjera hidroenergjetike me mundësi potenciale më të mëdha, si edhe për vështirësitë e lidhjes me rrjetin elektrik kombëtar të shpërndarjes;

- realizimin e fuqisë totale të instaluar jo më pak se 14 MW,

bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nene të marrëveshjes shtesë të koncesionit, të miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, palët kontraktuese bien dakord të bëhen këto ndryshime.

Neni 1

Në tekstin e marrëveshjes shtesë të koncesionit, të miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave:

- kudo ku është shprehur "...sipas tabelës A.../në tabelën A..." zëvendësohet me "...sipas aneksit 1/në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje...".

Neni 2

Në nenin 2, fjalët "...Projekti: Rehabilitimi i hidrocentraleve të vegjël vendore, në të gjithë Shqipërinë (0.2-1.2 MWA fuqi), sipas tabelës A bashkëlidhur dhe në përputhje me formën ROT (Rehabilitim, shfrytëzim, transferim)..." zëvendësohen me "...Projekti: Rehabilitimi i hidrocentraleve të vegjël vendore, në të gjithë Shqipërinë, me fuqi totale të instaluar jo më pak se 14,440 kW, sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, dhe në përputhje me formën ROT (Rehabilitim, shfrytëzim, transferim)..."

Neni 3

Në nenin 3, fjalët "...për një shumë jo më pak se 10 661 000 (dhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) euro..." zëvendësohen me "...për një shumë jo më pak se 9 916 000 (nëntë milionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) euro..."

Neni 4

Në nenin 4, fjalët "... do të jetë në vlerën 10 661 000 euro..." zëvendësohen me "...do të jetë në vlerën jo më pak se 9 916 000 (nëntëmilionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) euro..."

Neni 5

Në nenin 5, fjalët "...Koncesionari garanton të përfundojë projektin brenda datës 31 dhjetor 2009" zëvendësohen me "...Koncesionari garanton të përfundojë projektin brenda datës 31 dhjetor 2010..."

Neni 6

Në fund të nenit 5, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“-Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.”.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet përshkruara në nenet 1-6 më lart, kanë fuqi për të dy palët.

Nenet e tjera të marrëveshjes shtesë nuk kanë ndryshuar.

Kjo Marrëveshje mbahet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja palët, administratorit, z.Giordani Gorini që është shtetas italian, iu lexuan italisht kontratat nga përkthyesja znj.Edlira Preza, e bija e Bajramit, e datëlindjes 3.11.1969, me nr.pasaporte Z1542284.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe
Energjetikës
Përfaqësuar nga z.Genc Ruli

Për Koncesionarin
“ESSEGEI” S.p.A
Përfqësuar nga ing.Giordani Gorini

ANEKS 1

PLAN REHABILITIMI PËR 22 HEC VENDORE							
Nr	Emri i HEC-it	Vendndodhja rrethi	Fuqia e instaluar para rehabilitimit (Kw)	Fuqia e instaluar pas rehabilitimit (Kw)	Prodhimi max vjetor (kWh)	Afati i përfundimit të investimit fundi i vitit	Investimi (euro)
1	Arras	Dibër	1200	2400	10,000,000	2009	1,680,000
2	Funares	Librazhd	1000	1000	4,600,000	2009	563,000
3	Dukagjin	Shkodër	640	640	3,200,000	2010	508,000
4	Nikolice	Korçë	500	500	1,800,000	2010	290,000
5	Bulqizë	Bulqizë	400	600	2,000,000	2009	400,000
6	Lurë	Dibër	400	600	1,650,000	2009	225,000
7	Orgjost	Kukës	400	800	3,000,000	2009	430,000
8	Lerëbibaj	Tropojë	400	1200	4,800,000	2010	765,000
9	Velçan	Korçë	320	800	3,000,000	2010	605,000
10	Zerqan	Bulqizë	250	400	2,000,000	2009	250,000
11	Borsh	Sarandë	250	250	750,000	2009	180,000
12	Leshnicë	Sarandë	250	250	750,000	2009	215,000
13	Shoshan	Tropojë	230	3000	12,000,000	2010	1,940,000
14	Ujanik	Skrapar	220	400	1,500,000	2009	282,000
15	Kerpice	Gramsh	200	200	950,000	2009	180,000
16	Barmash	Kolonjë	200	200	800,000	2009	180,000

17	Lunik	Librazhd	200	200	800,000	2009	160,000
18	Homesh	Bulqizë	150	150	650,000	2009	160,000
19	Muhur	Dibër	250	250	950,000	2010	250,000
20	Rajan	Kolonjë	200	200	1000,000	2010	263,000
21	Marjan	Korçë	200	200	930,000	2010	230,000
22	Treskë 2	Korçë	160	200	600,000	2009	160,000
	Totale		8,020	14,440	57,730,000	2010	9,916,000